

Aktivitetet me Junior Rangers




Pas pushimeve verore për grupin Junior Rangers ata rikthehen sërish në park me aktivitete të ndryshme në kuadër të ditës Botërore të Lumenjëve.

Rojtarët e vegjël me ndihmën e Stafit të AdZM realizuan disa aktivitete në lidhje me këtë ditë mjedisore si marrjen e njohurive dhe informacioneve mbi lumenjtë dhe më pas vijimi i aktiviteteve si Birdëatching dhe pastrim i territorit nga mbetjet plastike

Grupi Junior Ranger do të vijojë me përfshirjen e tyre në aktivitete të ndryshme për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e natyrës.

Punonjësit e Parkut



Mirela Spaho punon si Specialiste Menaxhimi në Administratën e Zonave të Mbrojtura Fier. Mirela si punë kryesore cdo ditë ka pjesën e Programin të Edukimit Mjedisor, pritjen dhënjën e informacioneve dhe orientimin e turistëve të huaj dhe vendas në Park.

Gjithashtu, merr pjesë në projekte që i përkasin menaxhimit të zonave të mbrojtura të qarkut si edhe në promovimin e Bujqësisë së Qëndrueshme.

Bashkëpunon me strukturat lokale dhe aktorë të tjerë për përdorimin e qëndrueshëm të ZM-ve.

Përsa i përket programit të Edukimit Mjedisor mer pjesë në realizimin e aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen me nxënësit dhe mësues të shkollave brenda parkut dhe me grupin Junior Ranger të mbështetur nga Projekti JICA


BULETINI INFORMATIV

PER MUAJIN TETOR 2022

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve Për Përmirësimin e Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem në Parkun Kombëtar Divjakë - Karavasta



Administrata e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta
Adresa: Zyrat e Parkut 9022 Divjakë, Lushnjë
Tel: (+355) 69 890 0540
Email: dknpmmedia@hotmail.com



SCAN ME
Instagrami i
Projektit JICA



SCAN ME
Facebook
AdZM Fier

Edukimi Mjedisor

Në kuadër të planit të Edukimit Mjedisor, më 20 Shtator u mbajt Mbledhja e Grupit të Punës ku Eksperti Japonez z.Ryunosuke Ogaëa mbajti një prezantim mbi ecurinë e deritanishme të parkut si dhe punën që po kryhet për hartimin e menuve edukative mjedisore që do të përdoren nga shkollat vendase dhe Stafi i AdZM si pjesë e programit ekstrakurrikular të arsimit.

Këto menu do të ndihmojnë mësuesit të plotësojnë orët e tyre të lira me potencialin që ofron parku duke zbatuar aktivitete të ndryshme në shkolla dhe brenda zonës së parkut.

Gjatë takimit, mësuesit e shkollës shprehën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me projektin JICA dhe stafin e Administratën e Zonave të Mbrojtura Fier.

Takimet të tjera që do të zhvillohen deri në zyrtarizimin e këtyre menuve në të gjitha shkollat deri në fund të projektit.



Panairi i Produkteve Bujqësore.



Më 11 shtator, projekti organizoi me fermerët vendas "Panairin e Produkteve Bujqësore Divjakë" për produktet bujqësore vendase të prodhuara brenda territorit të Parkut Kombëtar.

Ky aktivitet është pjesë e aktiviteteve të projektit në kuadër të komponentit për promovimin e bujqësisë së qëndrueshme në zonën e PKDK.

Panairi u organizua përpara Qendrës së Vizitorëve të PKDK. Fermerët vendas demonstruan prodhimet e tyre si karota, patate, pjepër, shalqi, lulëlakër, lakër, rrush, domate, spec jeshil, qepë etj.

Kjo periudhë ishte shumë e përshtatshme për organizimin e këtij eventi pasi numri i vizitorëve që vizitojnë PKDK dhe Qendrën e Vizitorëve është më i lartë.

Monitorimi i Biodiversitetit

Këtë muaj në kuadër të projektit JICA, në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta, në kuadër të Monitorimit të Biodiversitetit u realizua Trajnimi i 2-të për Monitorimin dhe Identifikimin e Specieve Bimore.

Dr. Alfred Mullaj, profesor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, mbajti një prezantim për stafin e AdZM mbi Florën Halofitike dhe habitatin e saj në Parkun Kombëtar Divjakë – Karavasta.

Pas prezantimit, të gjithë pjesëmarrësit, stafi i AdZM Fier dhe stafi i projektit JICA vazhduan trajnimin në terren duke monitoruar speciet e ndryshme bimore dhe habitatet halofitike që gjenden në Parkun Kombëtar të Divjakës.

Gjithashtu u diskutua për ecurinë e rëndësishme të programit të monitorimit iNaturalist, të cilin stafi i AdZM po e përdor për monitorimin e florës dhe faunës së PKDK që nga viti i kaluar.

